

Përse ju katundarët i keni kaq shtrenjtë?

Fare pak për ne katundarët dhe katundarinë larg dhe afër qytetit, kasabasë

..... fshatari është i madhërishtëm me jetën e tij hallemadhe.

Nga Honore de Balzak, Romani “Fshatarët”, Les paysans

Të ngritur pa zbardhur dita, sapo kanë kënduar gjelat, gra, burra të brezave të ndryshëm, hedhin në krahë torbat, çantat, hejbet, për të kapur fugonin më të parë, duke parashikuar se do të përballen dhe me pakënaqësinë e shoferit sidomos kur kanë me vete dhe pula e gjela.

Para se të nisen ata nuk kanë harruar tu lënë detyra e porosi pjestarëve të tjerë të familjes për të grazhduar lopët, të imtat, njëthundrakët dhe për ti nxjerrë në kullotë sa më herët.

Edhe detyra të tjera kanë qenë të shumta, mbathja e kuajve, arnimit i samarëve, mprehja dhe kalitja e veglave të punës tek ustai, kovaçi i fshatit, mbasi disa kishin dhe ditën e caktuar që nuk e kapnin më, ishte normë që atë ditë pergatisnin dhe drekën për kovaçin, ustanë, (grafikun - siç quhet nga gjenerata e sotme).

Më të shqetësuar dhe më shumë merak dhe mosbesim ndaj pjestarëve të familjes largoheshin ata që kishin ditën e ujit, duke i këshilluar tu rrinin larg çdo grindje duke ua transmetuar atyre për të disatën herë që “shejtani rrin në ujë”.

Pak më vonë, pas krahëve të tyre, do të fillonte melodia baritore: Pallja e lopëve, blegrima e deleve e dhive, lehja e qenëve, hingëllima e kuajve, pa llogaritur mjauullitjen e maceve etj, që të gjithë kërkonin ndihmë, kuptohet në gjuhën e tyre.

Pasi kanë përballuar këtë situatë pakënaqësie, lodhje dhe mërzitje që në agim, ata do ti drejtohen trotuarit për ti treguar blerësit, qytetarit që ka patur dhe kohë të flejë, ato çfarë kane sjellë: spinaq, pazi, labot, hithra, kopër, majdanoz, lëpjetë, sinap, lulëkuqe, (kuptohet pa rënë në farë), vezë të freskëta dhe shumë fruta, perime e prodhime të tjera.

Pjesa më e madhe e tyre, (të gjithë specialistët e bujqësisë e dinë) konsideroheshin dhe klasifikoheshin si barëra të këqija, duke angazhuar shumë forca pune për ti çrrënjësuar, (eradikuar thonë akademikët), por ja, që erdhi një ditë dhe po kërkohen. Të nevojshme për të gjitha moshat, der tek më të moshuarit, nuk lodhin stomakun, rrisin perilstatikën e zorrëve, thonë doktorët etj, etj.

Për të qenë të sigurtë, shumë nga këto nuk i kanë ditur dhe ato që sot do të qëndrojnë në trotuar, pa pyetur për të ftohtit a për vapën. Dhe të gëzon fakti që këto pavarësisht nga arsimiti i tyre, janë në gjendje të flasin për vlerat e disa prej produkteve që i rrjeshtuam me lart.

Një pjesë e atyre që kanë sjellë për ti shitur nuk do të thotë që u kanë tepruar, (shumica e atyre nuk e dinë se çfarë është ekonomia e tregut, të paktën teorikisht), por duke kufizuar, reduktuar racionin ditor të familjes.

Që në fillim (dhe ata e parashikojnë ose e presin) që të ndeshen me pyetjen e blerësit, qytetarit (nuk desha ta përmend fjalën përçmim):

Përse ju katundarët i keni kaq shtrenjtë?

Një përgjigje nën zë: Po pse more zotëri, a është shtrenjtë një koka kola qumësht i freskët, pothuajse i barabartë me çmimin e ujit, dhe mos harro se vetëm kur ka pjellë lopa unë kam fjetur në stallë, të paktën një javë përpara.

Sa shpejtë e harrove radhën e qumështit që në orën tre të natës për një litër qumësht që ishte më shumë ujë, dhe tani vetëm mos përto të ngrihesh e ta marrësh qumështin tek dera.

Apo kur unë i lutesha shitëses së bukës për një bukë gruri që unë e kisha prodhuar vetë, dhe përgjigja ishte se ju katundarët nuk e keni emrin në listë.

Dhe tani, për të mos u zgjatur, le të krahasojmë ato që ka sjell ky fshatar/ katundar, fermer në raport me ato që gjejmë në tregje, deri diku të kompletuar, me kushte të pranueshme:

Freskia e produktit;

-Njihet dhe kuptohet edhe nga blerësi, freskia, bile dhe koha e vjeljes, në mëngjez apo në darkë, origjina e produktit, kushtet klimatiko tokësore. Mund ta ilustrujmë vetëm një shembull: fasulja e lartësive edhe në saj të rrezatimit të bollshëm ultra violet, që mbërrin në arë, ka shije dhe vlera të pakrahasueshme me ato që vijnë nga fusha, ndërkohë që ka mbërritur dhe fasule e rritur në vapën e Misirit, Egjypt, ku për të cilën Çajupi thoshte: Fushë, fushë dhe fushë prapë, fushë e pasosur me shumë vapë.....

-Çfarë agrofondi është përdorur, plehrimet, spërkatjet etj. A është tepruar me plehrime dhe me sperkatje. Gjethoret në një teprim të ushqimit azotik akumulojnë nitrite, shumë të dëmshme për organizmin e njeriut, gjë që nuk ndodh në këtë fermën “shumë të vockël” siç themi ne Korçarët, dhe që prezantohet nga ky shitësi i trotuarëve.

-Çfarë kërkesash ka për kulinarinë, ose më thjeshtë çfarë duhet të dijë amvisa, e zonja e shtëpisë?

Përsëri një shembull disi sinjifikativ, domethënës: Fasulja e ardhur nga lartësitë nuk mund të zihet me çfardo lloj uji, që lidhet kryesisht me fortësinë e ujit, mundësisht, por që nuk mund të arrihet, të zihet me ujin që është ujitur. Edhe në këtë rast ky katundari të ofron dhe me dashamirësi dhe atë që quhet “recipe” apo mënyra e të gatuarit që ju nuk do ta gjeni asgjëkund.

Nëse do të kesh dashmirësi mund të miqësohet dhe me “katundarin” të cilit i adresohesh, abonohesh, për këto prodhime. Përgjithësisht ruhet sedra e tij që nuk abuzon me këtë miqësi të rastësishme të lindur në trotuar në e zheg apo në thëllime.

Atëherë pse të mos u krijojmë kushte këtyre shitësve, që janë realisht njëherësh dhe prodhues, që të prezantojnë produktet e tyre të prodhuara me kaq shumë mund, nga një herë duke u hequr nga goja fëmijëve dhe jo se u kanë tepruar?

Së fundi dhe drejtuesit e pushtetit vendor, sa herë që premtojnë për tregje moderne, mbase të mendojnë për këtë “mini treg”, apo për tregun e trotuarit, gjithësesi për ta përmirësuar atë, për të motivuar këtë fermer për vazhdimësinë e prodhimit.

Pse jo për të ndërtuar një skenar të marketingut, që ato aktualisht nuk e dijnë dhe jo që nuk e kupton, mbasi filozofia e marketingut fillon dhe mbaron me blerësin dhe jo vetëm unë por të gjithë e bien dakord që ai e kupton dhe e ka kuptuar dhe gjysh stërgjyshi i tij, që është e kuptueshme.

Kthimi nga pazari, tregu, pjesa e dytë e shkrimit, ku nuk është i nevojshëm epilogu, ndërsa prologu ishte i domosdoshëm.

Me pak fjalë pa u ulur, me bukën në dorë, detyrohen të rimarrin detyrën e rivazhdimit të situatës.

Por kjo do të ishte aspak e rëndësishme në raport me atë që perceptojnë kur janë kthyer pa i shitur ato që morën në mëngjez për në Pazar!!!!

Zhënjim, dëshpërim, mërzi, se nuk u sollën fëmijëve, apo nipërve ato që u premtuam në mëngjez, kuptohet që këto të fundit nuk arrijnë dhe shqyr që nuk arrijnë të kuptojnë këto halle dhe peripeci që disi u përpoqëm ti themi më lartë, mbasi do të kenë kohë.

Idriz Xhomara

Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

